

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	07.10.2024	Sipas Urdhërit 251, datë 22.08.2022, janë miratuar planet e mbarështrimit të ekonomive pyjore “Dushku i Bulçarit”, “Gramsh-Vinë”, “Holtë-Lukovë”, “Rovë”, dhe “VidhanSkënderbegas” në Bashkinë Gramsh të cilat janë financuar nga Banka Botërore. Pas korrespondencave me Bashkinë Gramsh dhe verifikimit të dokumentacionit kemi konstatuar ndryshime të kufijve të ngastrave e nënngastrave pyjore dhe kullosore. Po citojmë ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, Neni 5 “Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar”, pika 4. Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me: a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha; c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha. Pas verifikimeve na rezulton se	10.10.2024	Në përgjigje të kërkesës suaj, ku kërkohet informacion dhe shpjegime mbi ndryshimet e kufijve të parcelave, specifikisht: parcela 1, parcela 2, parcela 3, parcela 4, parcela 5, parcela 6, parcela 7, parcela 8 që mungon në planin e mbarështrimit, po ashtu mbi ndryshimin e kufijve të parcelave në të gjithë Ekonominë Pyjore “Gramsh-Vinë”, ju bëjmë me dije se:  Bashkia Gramsh nuk ka depozituar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dokumentacionin teknik të Planeve të Mbarshtimit të Miratuara, edhe mbas disa kërkesave të persëritura nga ana jonë. Në këto kushte ne nuk mund të verifikojmë konstatimet e cituara nga ju.  Për sa më sipër, lutem drejtohuni Bashkisë Gramsh dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të cilat e disponojnë këtë informacion. Lidhur me pyjet private, referuar pikes nr. 18 të nenit nr.3 të ligjit nr 57/2020 “Për Pyjet” ju sqarojmë se nuk hiqen nga fondi pyjor pyjet private, por në bazë të dokumentave ligjore që disponojnë pronarët, pyjet regjistrohen në pronësi private	E Plotë	0

	<p>në kundërshtim me ligjin kemi ndryshime të kufijve të parcelave, specifikisht: parcela 1, parcela 2, parcela 3, parcela 4, parcela 5, parcela 6, parcela 7, parcela 8 mungon në planin e mbarështrimit, po ashtu kemi ndryshim të kufijve të parcelave në të gjithë Ekonominë Pyjore “Gramsh-Vinë”. (shikoni hartat bashkëngjitur) Referuar ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë ka ndodhur me parcelën 1a, me sipërfaqe 7.9 hektarë? Me çfarë VKM është hequr kjo parcelë?</li> <li>• Çfarë ka ndodhur me parcelën 7a, me sipërfaqe 47 hektarë?</li> <li>• Çfarë ka ndodhur me parcelën 8a, me sipërfaqe 22 hektarë?</li> <li>• Çfarë ka ndodhur me parcelën 9a, me sipërfaqe 39.9 hektarë?</li> <li>• Në bazë të Udhëzimit nr.1 “PËR MBAJTJEN E KADASTRËS SË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR KOMBËTAR” kërkojmë të dhënat kadastrale për Ekonominë Pyjore Gramsh-Vinë nga viti 2015 deri në 31 dhjetor 2023, së bashku me miratimet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Të dhënat duhet të jenë për të dyja periudhat vjetore të raportimit. Po ashtu kërkojmë hartat përkatëse në rastin e ndryshimeve si dhe dokumentin</li> </ul>	<p>dhe qëndrojnë në fondin pyjor kombëtar që njeh dy forma pronësie Publike dhe Private.</p> <p>Për sa i përket pyetjes: Kërkojmë të dhënat kadastrale për Ekonominë Pyjore Gramsh-Vinë nga viti 2015 deri në 31 dhjetor 2023, së bashku me miratimet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Të dhënat duhet të jenë për të dyja periudhat vjetore të raportimit. Po ashtu, kërkojmë hartat përkatëse në rastin e ndryshimeve si dhe dokumentin që ka miratuar këto ndryshime ju bëjmë me dije se:</p> <p>Agjencia Kombëtare e Pyejeve është krijuar në vitin 2020 dhe në këtë fazë që ALFIS është i paaksesueshëm për të gjeneruar të dhënat që ju kërkonte, si rrjedhojë nuk mund t’i përgjigjemi pyetjes suaj.</p>		
--	---	---	--	--

		<p>që ka miratuar këto ndryshime. Në planin e mbarështrimit këto parcela janë cilësuar nga Bashkia Gramsh si prona private.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Me çfarë dokumenti janë privatizuar këto pyje?</li> </ul>				
02	10/11/2024	<p>Në vazhdimësi të korrespondencës me institucionin tuaj dhe referuar ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, si dhe referuar ligjit 57/2020 “Për Pyjet”, Kreu II, Neni 5 “Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar”, pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni kërkojmë nga institucioni juaj verifikimin e konstatimeve tona në lidhje me ndryshimet e kufijve të ngastrave e nën-ngastrave pyjore dhe kullosore në Ekonominë Pyjore “Gramsh-Vinë”.</p>	10/30/2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj me Nr.175 prot, datë 01.10.2024 ku kërkohet si më poshtë cituar :</p> <p>Verifikimin e konstatimeve tona në lidhje me ndryshimet e kufijve të ngastrave e nënngastrave pyjore dhe kullosore në Ekonominë Pyjore “Gramsh-Vinë”, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Bashkia Gramsh nuk ka depozituar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dokumentacionin teknik të Planeve të Mbarshtimit të Miratuara, edhe mbas disa kërkesave të persëritura nga ana jonë. Në këto kushte ne nuk mund të verifikojmë konstatimet e cituara nga ju. Për sa më sipër, lutem drejtohuni Bashkisë Gramsh dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të cilat e disponojnë këtë informacion. Në këtë fazë që ALFIS është i paaksesueshëm për të gjeneruar të dhënat që ju kërkoni, si rrjedhojë nuk mund t’i përgjigjemi pyetjes suaj.</p>	E Plotë	0

03	31.10.2024	<p>Referuar Urdhërit të Ministrit nr. 251, datë 18.08.2022 “PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE “DUSHKU I BULCARIT”, “GRAMSH – VINË”, “HOLTË - LUKOVË, “ROVË” DHE “VIDHAN - SKËNDERBEGAS”, BASHKIA GRAMSH, pika 3 ju ngarkon si një prej strukturave përgjegjëse për hedhjen e të dhënave në sistemin ALFIS si dhe për të bërë përditësimet përkatëse në Regjistrin e Fondit Pyjor.</p> <p>Ndërkohë referuar shkresës suaj me nr.810. prot, datë 11.10.2024 ju shpreheni konkretisht: “Bashkia Gramsh nuk ka depozituar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dokumentacionin 2 teknik të Planeve të Mbarështimit të Miratuara”, edhe mbas disa kërkesave të përsëritura nga ana jonë”.</p> <p>Bazuar në ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;</p> <p>1. Në këto kushte si është e mundur që ekziston Urdhëri i Miratimit nr. 251 (të cilin e gjeni bashkëngjitur) kur Bashkia Gramsh nuk ka depozituar në AKP dokumentacionin teknik?</p> <p>2. A jeni njohur ju me urdhërin</p>	11/11/2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj me Nr. 176 prot. datë 01.11.2024, në të cilën janë drejtuar pyetjet si më poshtë cituar, ju bëjmë me dije përgjigjen për secilën prej tyre :</p> <p>1.Në këto kushte si është e mundur që ekziston Urdhëri i Miratimit nr. 251 (të cilin e gjeni bashkëngjitur) kur Bashkia Gramsh nuk ka depozituar në AKP dokumentacionin teknik?</p> <p>Kësaj pyetjeje i jemi përgjigjur me shkresën nr. 810 prot. datë 11.10.2024.</p> <p>2.A jeni njohur ju me urdhërin nr.251 “PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE “DUSHKU I BULCARIT”, “GRAMSH - VINË, “HOLTË - LUKOVË, “ROVË” DHE ”VIDHAN - SKËNDERBEGAS”, BASHKIA GRAMSH”?</p> <p>3.A jeni njohur ju me shkresën nr.3290/3, datë 30.08.2022 e cila Bashkisë Gramsh nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit?</p> <p>4.A i jeni drejtuar ju Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me një shkresë ku e informoni se nuk është depozituar pranë jush dokumentacioni teknik nga Bashkia Gramsh?</p> <p>5.A jeni ju në këtë rast në shkelje të Urdhërit të Ministrit nr.251, duke mos hedhur të dhënat në sistemin ALFIS?</p> <p>Pyetjet 2, 3, 5, janë përsëritje të njëra-tjetrës dhe përgjigja është dhënë shteruese në shkresën nr. 810 prot. datë 11.10.2024.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes nr. 4, ju bëjmë me dije se me shkresën nr. 506 prot. datë 06.06.2024 ju jemi drejtuar të gjithë bashkive për dërgimin në AKP të të gjithë dokumentacionit të PM të miratuara.</p>	E plotë	0
----	------------	---	------------	---	---------	---

	<p>nr.251 “PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE “DUSHKU I BULCARIT”, “GRAMSH - VINË, “HOLTË - LUKOVË, “ROVË” DHE ”VIDHAN - SKËNDERBEGAS”, BASHKIA GRAMSH”?</p> <p>3. A jeni njohur ju me shkresën nr.3290/3, datë 30.08.2022 e cila Bashkisë Gramsh nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit?</p> <p>4. A i jeni drejtuar ju Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me një shkresë ku e informoni se nuk është depozituar pranë jush dokumentacioni teknik nga Bashkia Gramsh?</p> <p>5. A jeni ju në këtë rast në shkelje të Urdhërit të Ministrit nr.251, duke mos hedhur të dhënat në sistemin ALFIS?</p> <p>6. Ju shpreheni se sistemi ALFIS nuk funksionon, me çfarë të dhëna dhe në çfarë mënyre e kryen detyrën institucioni juaj kur sistemi kryesor që ju pretendoni se menaxhon të dhënat është jashtë funksionit?</p>		<p>6. Ju shpreheni se sistemi ALFIS nuk funksionon, me çfarë të dhëna dhe në çfarë mënyre e kryen detyrën institucioni juaj kur sistemi kryesor që ju pretendoni se menaxhon të dhënat është jashtë funksionit? “</p> <p>Në lidhje me funksionimin e ALFIS-it I jemi drejtuar disa herë AKSHI-it për rëndësinë e funksionimit të ALFIS-it dhe përfundimin e procedurës së mirëmbajtjes dhe përmirësimit të funksionaliteteve të sistemit.</p>		
--	--	--	---	--	--